



TË GABOSH ËSHTË NJERËZORE, POR TË FALËSH ËSHTË HYJNORE

Ne jemi njerëz, qenie të gjalla, ndoshta më të specializuara nga formimi i organizmit, por jo më perfektet nga ana e të vepruarit. Të mos jesh perfekt do të thotë të gabosh. Të gabosh do të thotë të jetosh, të ndjesh, të mësosh, të kuptosh, të kesh një të nesërme për të bërë atë që s'arrite sot. Gabimi është pjesë e pandashme e jetës sonë që na bënë të njehemi njerëz.

Gabojmë për gjëra të ndryshme, në saj të të ndjerit shumë fort për ata që na rrethojnë, ose në saj të egoizmit. Shpesh gabojmë, sepse i trembemi së vërtetës apo asaj që është e drejtë, duke gënjyer për të mbrojtur atë, që vërtet duam apo duke iu futur një rrugë pa kthim, që duket më e shkurtra, por ajo më e padrejta. Për të mbrojtur atë që mendojmë apo veten tonë, ndodh që lendojmë njerëz në forma të ndryshme.

Njerëzit të cilët lëndohen janë me fat, nëse gëzojnë një dhunti të pakrahasueshme me të natyrshmen, atë të të falurit. Duhet të jesh vërtet diçka mbi veten, që të ndërmarësh një vendim të tillë për t'i bërë mirë atij që dikur të ka shkaktuar dhimbje. Po ç' do të thotë të falësh?

Të falësh dikë do të thotë të mohosh veten dhe të kaluarën tënde. T'i hapësh përsëri zemrën dikujt, që më parë e mbylli atë në vetvete. T'i thuash një fjalë emocionuese atij, që dikur pushoi së ndjeri. Të tregohesh zemërgjerë e i dashur me dikë, që më parë e ngujoi zemrën e harroi se kishte ndjenja. T'i flasësh ëmbël atij, që dikur të qëlloi si plumb me fjalën e tij të fundit. Të harrosh, të fshish, të duash pa masë, të mund të thyesh apo të shkrish akullin me lotët që pikojnë pa mbarim.

Kjo është të falësh. Të duash më shumë se veten. Kurse të gabosh është të bësh thjesht çfarë je brenda mundësive të tua. Prandaj, të falësh është hyjnore...

S.K